

OPERATORI I BLERJEVE TË PËRQËNDRUARA

Data 02.04.2025

PROCESVERBAL- Tipi i kontratës - Shërbime**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM***(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)*

OBJEKTI I PROCEDURËS: “Shërbim i mirëmbajtjes të sipërfaqeve të gjelbra për QSUNT, për 24 muaj”

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (FPP) 77310000-6.

VLERA E FONDIT LIMIT: **35,684,604.80** (tridhjetë e pesë milion e gjashtëqind e tetëdhjetë e katër mijë e gjashtëqind e katër pikë tetëdhjetë) lekë, pa TVSH ose 359,687.57 (treqind e pesëdhjetë e nëntë mijë e gjashtëqind e tetëdhjetë e shtatë pikë pesëdhjetë e shtatë) euro pa tvsh.

Referuar kursit të këmbimit të Bankës së Shqipërisë datë 02.04.2025 (99.21 lekë/euro).

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik” (i ndryshuar), nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (i ndryshuar), autoriteti/enti kontraktor **Operatori i Blerjeve të Përqëndruara sh.a** ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar.

KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 10*

b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;*

2. Ofertuesi duhet të paraqesë:

2.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:

Sipas kriterëve të përgjithshme të kualifikimit, të vendosura në pikën 1 të shtojcës 9 të DST.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a dhe 2, të LPP, nenit 41, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (i ndryshuar), duke vlerësuar që plotësimi i kriterëve të përgjithshme të kualifikimit, të vendosura në pikën 1 të shtojcës 9 të DST provon mjaftueshëm përshtatshmërinë profesionale të ofertuesve.

2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore të 3 (tre) viteve të fundit financiare (2022-2023-2024), ku

vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se vlera e fondit limit.

Kërkesa e mësipërme konsiderohet e përmbushur nëse operatorët ekonomike arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është në nenin 77, pika 3, të ligjit nr.162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” të ndryshuar; nenin 43 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” të ndryshuar, ku është përcaktuar qartë vlera e kërkuar për xhiron minimale vjetore, dhe pikës 3 të nenit 77 të ligjit nr.162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, si dhe Rekomandimit të APP-së nr7998 datë 24.12.2021. Vlera e kërkuar është brenda kufijve të vendosur në dispozitat më sipër, dhe është vendosur me qëllim që AK të sigurohet për potencialin ekonomiko-financiar të OE ofertues, që lidhet drejtëpërdrejtë me qëndrueshmërinë dhe vijimësinë e veprimtarisë së operatorëve ekonomikë në treg, si një element i rëndësishëm në realizimin e objektit të prokurimit dhe përmbushjes së detyrimeve kontraktore.

AK në vendosjen e këtij kriteri ka mbajtur në vëmendje nenin 61 të Ligjit nr.29/2023 "Për tatimin mbi të ardhurat" si dhe kërkesat e Ligjit nr. 25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”.

2.2.2 Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin bilancet vjetore, për vitet financiare (2022, 2023, 2024), të shoqëruara me Akt Ekspertizen e Ekspertit Kontabël të Autorizuar, vetëm në rastin kur janë në kushtet e përcaktimeve të nenit 41 të Ligjit Nr. 10091 datë 05.03.2009 “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabël të regjistruar dhe të kontabilistit të miratuar”, i ndryshuar.

Kriteri konsiderohet i përmbushur nëse në dy balance të njëpasnjëshme nuk ka raport negative ndërmjet aktivitetit dhe pasivit.

Argumentimi: Kriteri vendoset bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP; të nenit 43, pika 4, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, si dhe të nenit 41 të ligjit nr.10091, datë 05.03.2009 “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabël të regjistruar dhe kontabilistit të miratuar”, i ndryshuar.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e balanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, në Ligjin nr. 9920 datë 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, dhe aktet nënligjore në zbatim të tij.

Kriteri ekonomik dhe financiar i shërben autoritetit kontraktor për të krijuar sigurinë se operatorët ekonomik kanë kapacitet financiar për zbatimin e marrëveshjes kuadër.

2.3 Aftësitë teknike dhe profesionale:

2.3.1 Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për shërbimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në një vlerë jo më të vogël se 40 % të vlerës së fondit të limit të marrëveshjes kuadër.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

- a) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës, ose/dhe faturave tatimore të shitjes, të plotësuar sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

- b) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuar sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruar në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” (i ndryshuar) dhe nenit 41, pika 3 të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” (i ndryshuar). Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 40% të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme shërben kështu si një garanci për AK, që ofertuesit zotërojnë kapacitete dhe eksperiencë për të zbatuar kontratën, me sukses sipas një standarti të përshtatshëm cilësie dhe në përmbushje të specifikimeve teknike.

2.3.3 Operatori ekonomik ofertues duhet të dëshmojë dhe të paraqesë certifikatë (të vlefshme), si më poshtë si më poshtë:

SSH EN ISO 14001:2015 “Sisteme të menaxhimit të mjedisit” ose ekuivalente/të barazvlefshme.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a), nenin 79 të LPP, nenit 44 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

Standarti 14001: 2015 mbi “Sistemet e menaxhimit të mjedisit” – është vendosur si kriter duke marrë në konsideratë faktin që ky Standart është një sistem sistematik dhe i orientuar drejt procesit të menaxhimit të cilësisë për të kontrolluar impaktet e rëndësishme të aktiviteteve të biznesit në mjedis, dhe në rastin konkret duke qenë se objekt i prokurimit është mirëmbajtja e sipërfaqeve të gjelbra të territorit të QSUT-së ku ka të përfshirë edhe Spërkatje me insekticide, apo largimin e mbeturinave Paisja me këtë standart është e rëndësishme sepse siguron që ofertuesi do të zbatojë politika të qëndrueshme mjedisore, duke zvogëluar ndotjen dhe ndikimin e dëmshëm në mjedis.

2.3.4 Operatorët ekonomikë, për kryerjen e shërbimit të mirëmbajtjes objekt prokurimi për 6 zonat e territorit të QSUT-së, duhet të kenë të punësuar minimumi 10 (dhjetë) punonjës, si më poshtë:

- 1 punonjës Përgjegjës shërbimi
- 1 punonjës shofer
- 8 punonjës shërbimi

Për punonjësit e kërkuar me lart, duhet të paraqiten dokumentat:

a. Për Përgjegjësin e Shërbimit:

Përgjegjësi i shërbimit duhet të jetë Inxhinier Mjedisit/Ekspert Mjedisit, ose agronom (të ketë njohuri të mjaftueshme mbi bimësinë);

dhe për këtë punonjës duhet të paraqitet:

- Diplomë me profesion Inxhinier Mjedisit/ Agronom dhe/ose Certifikatë “Për Vlerësimin e ndikimit në mjedis dhe auditim mjedisor”;
- Kontratë pune (e vlefshme), si Përgjegjës shërbimi;

b. Për punonjësit shofer

- Kontratë pune përkatëse, (e vlefshme)
- Leje Drejtimi

- c. Për punonjësit e shërbimit, të paraqitet:
- Kontratë pune përkatëse, (e vlefshme)

Ky Kriter konsiderohet i permbushur me plotesimin e formularit sipas shtojcës 10 të DT. Dokumentet provuese të kërkuara më sipër, do të paraqiten nga ofertuesi i kualifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, ose nëse kërkohen sqarime nga Autoriteti Kontraktor.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, dhe nenit 41, pika 4/ b) dhe c), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë stafin, personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës.

Kriteri për punonjësit vendoset nga një analizë e specifikimeve teknike, grafikut të ekzekutimit të kontratës dhe termave të referencës, hartuar nga AK, me qëllim sigurimin e AK se shërbimi do të realizohet në kohë dhe sipas nevojave të përshkruara nga Autoriteti Kontraktor përfitues.

Përgjegjësi i shërbimit nevojitet për organizimin, drejtimin, ndarjen dhe mbikëqyrjen e punëve, me qëllim që shërbimi objekt prokurimi të kryhet sipas specifikimeve teknike.

Lidhur me kriterin për përgjegjësin e shërbimit është gjykuar e nevojshme se duhet të jetë Inxhinier Mjedisi/Ekspert Mjedisi, ose Agronom duke pasur parasysh natyrën e objektit të prokurimit i cili përfshin aspekte të mirëmbajtjes të sipërfaqeve të gjelbra, largimi i mbeturinave, pasi inxhinier mjedisit/ekspert mjedisi mbikqyr aspektet teknike dhe mjedisore të shërbimit apo Agronomi për menaxhimin dhe mbrojtjen e bimëve. Detyrat e përgjegjësit të shërbimit janë monitorimi dhe siguri që proceset e punës të jenë në përputhje me legjislacionin mjedisor. Gjithashtu mbikqyr praktikën e sigurisë në punë, duke siguruar që të mos shkaktojnë ndotje të ajrit, ujit apo dhe ndikime të tjera negative në mjedis. Gjithashtu mund të ndihmojë në zbatimin e protokolleve të sigurisë për punonjësit. Agronomi është përgjegjës për të zhvilluar dhe zbatuar një plan për mbrojtjen e bimëve nga sëmundjet dhe dëmtuesit. Kjo përfshin përdorimin e pesticideve jo të dëmshëm për mjedisin. Siguron që sipërfaqet e gjelbra të kenë një pamje të bukur dhe të mirëmbajtur. Kjo mund të përfshijë prerjen e barit, kujdesin për drurët dhe grumbullimin e mbetjeve që mund të ndikojnë në estetikën e hapësirës.

- 1 punonjës shofer – duke qenë se për kryerjen e proceseve të punës është kërkuar një autobot uji për vaditje, është e domosdoshme dhe kërkesa për një shofer për drejtimin e makinës së sipërpërmendur.
- 8 punonjës shërbimi; Punonjësit e shërbimit janë të nevojshëm për të kryer të gjitha zërat e shërbimit, objekt prokurimi, si Pastrim me krehër bari, Punim me bel, mbjellje farë bari, Prashitje etj.

2.3.5 Operatori ekonomik, duhet të disponojë mjetet e mëposhtme:

- 2 (dy) Krasitëse ligustrash;
- 2 (dy) Korrëse bari;
- 1 (një) Fije motokosë;
- 1 (një) Motosharre;
- Gershere për krasitje;
- 1 (një) Autobot Uji për vaditje.

Për të vërtetuar përmbushjen e këtij kriteri, për mjetin Autobot Uji, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin: dokumentacion të plotë si akti që vërteton pronësinë, kontratë qiraje apo përdorimi dhe leje qarkullimi.

Për mjetet dhe pajisjet e tjera, operatori ekonomik, duhet të paraqesë dokumentacion që vërtetojnë se, këto pajisje dhe instrumente i ka në pronësi, ose me qera, ose me huapërdorje (fatura blerje /dokumente zhdoganimi /kontrata qiraje /kontrata huapërdorje /kontratë dhurimi / çdo dokument tjetër me anë të të cilit fitohet e drejta e pronësisë ose përdorimit sipas Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë), ku të identifikohen të dhënat teknike të tyre.

Kriteri konsiderohet i përmbushur me plotësimin e formularit sipas shtojcës 10 të DT. Dokumentet provuese të kërkuara më sipër, do të paraqiten nga ofertuesi i kualifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, ose nëse kërkohen sqarime nga Autoriteti Kontraktor.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, dhe nenit 41, pika 4/ ç, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion mjetet dhe pajisjet teknike për të përmbushur kontratën, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit.

Kërkesa për disponimin e mjeteve dhe pajisjeve të mësipërme lidhet ngushtësisht me të proceset që duhet të kryejë ofertuesi për realizimin e shërbimit, objekt prokurimi, siç është: Pastrim me krehër bari, Punim me bel, mbjellje farë bari, Prashitje, vaditje etj.

Numri i mjeteve është përcaktuar nga autoriteti kontraktor për llogari të së cilit po kryhet prokurimi, i cili ka hartuar specifikimet teknike.

2.3.6 Operatët ekonomikë duhet të deklarojnë se duhet të kenë gjatë gjithë kohës së shërbimit për të mundësuar kryerjen me cilësi të shërbimit, mjetet e nevojshme, që nga krehërat e barit, makinat korrëse, gërshërët për krasitje, koshat e nevojshëm për mbledhjen e mbeturinave (nga kositja, korrja, krehërimi etj), fidanë për zëvendësimin e rrënjëve të reja të dëmtuara, plehëra kimik, etj.

Argumentim: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar dhe pika 6 e nenit 41, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të deklarojnë se do të sigurojnë furnizimin me mjete e sipas specifikimeve të kërkuara.

2.3.7 Operatët ekonomikë duhet të deklarojnë se Punonjësit e kërkuar duhet të jetë i pajisur me veshjet përkatëse identifikuese të pajisur me doreza (të miratuara nga Autoriteti Kontraktor), me kartat identifikuese të personelit (të miratuara nga Autoriteti Kontraktor), si dhe do të zbatojnë rregullat e brendshme, rregulloren e monitorimit të këtij shërbimi, të vendosura nga Q.S.U.T-ja.

Argumentimi: Në bazë të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik” (i ndryshuar) dhe nenit 41, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” (e ndryshuar) , me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të sigurojnë që punonjësit do të pajisen me veshjet perkatese te dallueshme dhe te identifikueshme duke respektuar rregullat te cilat do te monitorohen nga AK perkatesisht QSUNT.

II. Argumentimi i specifikimeve teknike

Specifikimet teknike dhe përlogaritja e fondit limit janë përgatitur dhe hartuar nga Autoriteti Kontraktor “**QSUNT**”, për nevojat e së cilit, Operatori i Blerjeve të Përqëndruara, në cilësinë e Organit Qendror Blerës kryen procedurën e prokurimit, në zbatim të Ligjit nr. 162/2020 “*Për prokurimin publik*”, i ndryshuar, VKM-në nr.531 datë 7.9.2023 “*Për krijimin e shoqërisë aksionare shtetërore “Operatori i Blerjeve të Përqëndruara” Sh.a për kryerjen e procedurave të veçanta të prokurimit publik, në emër dhe për llogari të Kryeministrit, Ministrave dhe Institucioneve të Varësise*”, i ndryshuar.